



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Kom.Dh.Shk.II.nr.791/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS– Dhomat e Shkallës së Dytë, gjyqtarin Faton Bajrami, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit ProCredit Bank, me seli ne Prishtinë, rr. “Xhorxh Bush”, nr.26, kundër debitorëve 1. “Delikates” DOO, me seli në Prizren, rr. “Besëlidhja”, nr.4, të cilën e përfaqëson A.B. dhe 2. E.B. nga Prizreni, me autorizimi e përfaqëson Murat Paçarada, avokat nga Prishtina, me objekt përmbarimi në bazë të vendimit administrativ, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorëve të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm PPP.nr.31/2023 të datës 20.04.2023, me datën 08.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e debitorit “Delikates” DOO, me seli në Prizren, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm PPP.nr.31/2023 të datës 20.04.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin e atakuar PPP.nr.31/2023 të datës 20.04.2023, në dispozitiv e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën e datës 24.11.2022 e debitorëve “Delikates” DOO, me seli në Prizren, rr. “Besëlidhja”, nr.4, të cilën e përfaqëson A.B. dhe 2. E.B. nga Prizreni, për përjashtimin e përmbaruesit provat Mehdi S. Reshani nga Prizreni, si organ i autorizuar përmbarues për të vendosur në lëndën e përmbarimit P.nr.157/20.

Kundër aktvendimit të lartcekur, brenda afatit ligjor, ankesë kanë parashtruar debitori për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të ligjit për falimentim, për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozimin që të aprovohet ankesa e debitorit në tërësi si e bazuar dhe të përjashtohet përmbaruesi privat Mehdi S. Reshani dhe të njoftohet kreditori mbi përjashtimin e përmbaruesit privat.

Kreditori nuk ka parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale - Dhomat e Shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) dhe gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se Zyra Përbarimore e përbaruesit privat Mehdi S. Reshani me seli në Prizren, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit ka lëshuar urdhër përbarimor me të cilin ka lejuar përbarimin në bazë të: Vendimit administrativ të formës së prerë të Agjencisë Kadastrale të Kosovës nr. ... të datës 30.05.2017, për shkak të detyrimit jo në të holla, lidhur me dorëzimin e paluajtshmërive: P-... ZK Dushanovë me sipërfaqe prej 2,241 m2 dhe P-... ZK Dushanovë me sipërfaqe prej 5,759 m2 dhe të shpenzimeve të përbarimit më shumë prej 118.00 euro. Debitorët pranë përbaruesit privat Mehdi S. Reshani, me datën 24.11.2022 kanë bërë kërkesën për përjashtimin e tij, për shkakë se përbaruesi në fjalë nuk ka qenë objektiv gjatë ndërmarrjes së veprimeve të përbarimit dh i njëjti i ka bërë shkelje të dispozitave ligjore të LPP-së.

Duke vendosur mbi prapësimin e debitorit dhe përgjigje në prapësim të kreditorit, gjykata e shkallës së parë ka nxjerr aktvendimin e ankimuar PPP.nr.31/2023 të datës 20.04.2023, në dispozitiv e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën e datës 24.11.2022 e debitorëve "Delikates" DOO, me seli në Prizren, rr. "Besëlidhja", nr.4, të cilën e përfaqëson A.B. dhe 2. E.B. nga Prizreni, për përjashtimin e përbaruesit provat Mehdi S. Reshani nga Prizreni, si organ i autorizuar përbarues për të vendosur në lëndën e përbarimit P.nr.157/20.

Gjykata shkallës së parë, ka konstatuar se në bazë të pretendimeve të debitorëve dhe në bazë të shkresave të lëndës, ka vlerësuar si të pabazuar pretendimin e palës debitore se, përbaruesi privat Mehdi S. Reshani ka qenë në dijeni se debitori gjendet në procedurë të falimentimit dhe kjo procedurë udhëhiqet me nr. VEF.nr.6/2021, dhe me këto veprime e ka shkelur nenin 9 par. 1 të LPP-së, mirëpo një pretendim i tillë është i pabazuar, pasi që përbaruesi privat nuk ka qenë në dijeni për inicimin e procedurës së falimentimit, dhe i njëjti është informuar me datën 18.11.2022, me email nga zyrtarët e Pro Credit Bank, dhe përbaruesi privat ka vepruar konform dispozitave ligjore të LPP-së. Përbaruesi privat me konkluzionin P.nr. 157/2020 të datës 03.11.2022, ka njoftuar debitorin E.B. që t'ia dorëzoj në posedim të lirë kreditorës ProCredit Bank, ngastrën kadastrale P-... ZK Dushanovë me sipërfaqe prej 2241m2, dhe P-7183023-00314-8 me sipërfaqes 5759 m2. Kështu, një veprim i tillë i përbaruesit privat si organ i përbarimit, është tërësisht i lejuar dhe nuk paraqet kurrfarë shkelje ligjore. Andaj, mbi bazën e këtyre fakteve dhe arsyeve, gjykata ka ardhur në përfundim që pretendimi i palës debitore ishte i pabazuar dhe nuk ka mbështetje juridike. Gjithashtu sipas nenit 325 par. 1-3 të LPP-së thuhet se: *"Dispozitat e ligjit të procedurës kontestimore për përjashtimin e gjyqtarëve vlejné përshtatshmërisht edhe për përjashtimin e përbaruesve privat. Gjyqtari i Gjykatës Themelore brenda territorit të cilit është emëruar përbaruesi privat, vendos për kërkesën për përjashtim. Nuk do të lejohet asnjë ankesë kunder aktvendimit i cili aprovon apo hedh poshtë një kërkesë për diskualifikimin e një zyrtari privat të përbarimit"*. Më tutje, në nenin 67 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), që ka të bëjë me përjashtimin e gjyqtarit nga gjykimi, thuhet se: *"Gjyqtari nuk mund ta procedojë çështjen juridike: ... g) në qoftëse ekzistojné rrethana të tjera që e vërejnë në dyshim paanësinë e tij"*. Në rastin konkret, pala debitore, ka kërkuar përjashtimin e përbaruesit privat, Mehdi S. Reshani për të vendosur në qështjen juridike të përbarimit, P.nr.157/2020, duke pretenduar faktin se ky përbarues privat si organ i përbarimit, është jo objektiv dhe nuk ka vepruar konform dispozitave ligjore të LPP-së. Mirëpo nga gjendja e shkresave të lëndës, kjo gjykatë ka gjetur se ky pretendim i palës debitore, nuk është i bazuar në ligji dhe nuk ka mbështetje ligjore, dhe se sipas gjendjes së tanishme të shkresave të lëndës P.nr. 157/2020, nuk mund të provohet se në rastin përkatës të përbaruesit privat Mehdi S. Reshani nga Prizreni, ekzistojné shkaqe për përjashtimin e tij si dhe nuk është provuar se ka pengese gjegjëse ligjore që ky përbarues privat të veproj në këtë çështjen juridike konkrete të përbarimit. Prandaj nuk janë plotësuar kushtet ligjore për përjashtimin e

përmbauesit privat Mehdi S. Reshani, si organ përmbaues për të vendosur në çështjen juridike të përmbaimit. Prandaj, mbi këtë bazë ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi të atakuar.

Gjykata Komerciale - Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka marr aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozitat e procedurës përmbaimore. Konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata Komerciale – Dhoma e Shkallës së Dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga nenin 182 paragrafi 2 pika b), g), j) dhe m) të LPK-së, dhe se drejtë janë zbatuar dispozitat ligjore të procedurës përmbaimore, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale – Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se Gjykata e shkallës së parë, me rastin e vendosjes si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar, ka konstatuar drejtë faktin kur e ka refuzuar si të pabazuar kërkesën e datës 24.11.2022 të debitorëve për përjashtimin e përmbauesit privat, me arsyetimin se përmbauesi privat Mehdi S. Reshani nuk ka qenë në dijeni për inicimin e procedurës së falimentimit, dhe se i njëjtit është informuar me datën 18.11.2022 me email nga zyrtaret e Pro Credit Bank, dhe se përmbauesi privat në këtë rast ka vepruar sipas dispozitave ligjore të LPP-së. Po ashtu, Kjo gjykate vlerëson se përmbauesi privat me konkluzionin P.nr. 157/2020 të datës 03.11.2022, ka njoftuar debitorin E.B. që t'ia dorëzoj në posedim të lirë kreditorës ProCredit Bank, ngastrën kadastrale P-... ZK Dushanovë me sipërfaqe prej 2241m2, dhe P-7183023-00314-8 me sipërfaqes 5759 m2. Kështu, një veprim i tillë i përmbauesit privat si organ i përmbaimit, është tërësisht i lejuar dhe nuk paraqet kurrfarë shkelje ligjore.

Kjo Gjykate, vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejt ka zbatuar edhe dispozitën e nenit 325 par. 1 nën paragrafi 3 të LPP-së, ku përcaktohet se *“Dispozitat e ligjit të procedurës kontestimore për përjashtimin e gjyqtarëve vlejnë përshtatshëmish edhe për përjashtimin e përmbauesve privat. Gjyqtari i Gjykatës Themelore brenda territorit të cilit është emëruar përmbauesi privat, vendos për kërkesën për përjashtim. Nuk do të lejohet asnjë ankesë kundër aktvendimit i cili aprovon apo hedh poshtë një kërkesë për diskualifikimin e një zyrtari privat të përmbaimit”*. Ndërsa me nenin , në nenin 67 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), që ka të bëjë me përjashtimin e gjyqtarit nga gjykimi, thuhet se: *“Gjyqtari nuk mund ta procedojë çështjen juridike: ... g) në qoftëse ekzistojnë rrethana të tjera që e vërejnë në dyshim paanësinë e tij”*. Ne rastin konkret palët debitorë kanë kërkuar përjashtimin e përmbauesit privat, mirëpo nga shkresat e lëndës, Kjo gjykate ka gjetur se kërkesa e debitorëve është e pa bazuar edhe e pa mbështetur në provat dhe se nuk ka mbështetje ligjore, me arsyetimin sipas shkresave të lëndës P.nr. 157/20 nuk rezulton se përmbauesi privat ekzistojnë arsye për përjashtimin e tij. Prandaj , Gjykata e shkallës së parë drejt ka vendosur kur ka vendosur kur e ka refuzuar si të pabazuar kërkesën e debitorëve për përjashtimin e përmbauesit privat nga lënda P.nr.157/2020.

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, si gjykatë e shkallës së dytë me rastin e vlerësimit të ligjshmërisë së aktvendimit të atakuar, mirëpo të njëjtat i vlerësoi si të pabazuar, për shkak se nuk kanë mbështetje në provat nga shkresat e lëndës.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, gjykata e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 208 dhe 209 pika b) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 dhe 77 të LPP-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e shkallës së dytë
Kom.Dh.shk.II.nr.791/23, me datë 08.05.2024

Gjyqtarin
Faton Bajrami d.v.